



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:167822

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05584292

Ac.nr.7097/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi, kryetar i kolegjit Nora Bllaca Dula dhe Hunaida Pasuli, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësve A..... B....., A..... K....., D..... M..... të tretë nga Rahoveci, si dhe V..... G..... nga fshati D....., Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati F..... H..... nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Av. B..... O....., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 12,444.52 euro, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.746/2021 të datës 13.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET Pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, **NDRYSHOHET Pjesërisht** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.746/2021 i datës 13.07.2022 në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit lidhur me kompensimin mbi bazën e kualifikimit, dhe shpenzimet e procedurës për precizimin e kërkesapdisë ashtu që gjykohet si në vijim:

REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve A..... B....., A..... K..... dhe D..... M..... që për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 18.06.2018 në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit t’ia paguaj:

paditëses **A..... B.....** nga Rahoveci, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore 18.04.2017 e deri 18.06.2018, për 27 % të pagës mujore (421,00 euro), 27 % =55,35 euro x 14 muaj, t’i paguaj shumën prej 774.90 euro.

Paditëses **A..... K.....** nga Rahoveci, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore 18.04. 2017 e deri 18.06.2018, për 35 % të pagës mujore (393,00 euro), 35 % =83,10 euro x 14 muaj, t’i paguaj shumën prej 1,163.40 euro

Paditësit **D..... M.....** nga Rahoveci, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore 18.04.2017 e deri 18.06.2018, për 27 % të pagës mujore (421,00), 27 % =55,35 euro x 14 muaj, t'i paguaj shumën prej 774.90 euro/

Paditësit të katërt **V..... G.....** nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore 18.04.2017 e deri 18.06.2018, për 35 % të pagës mujore (421,00 euro), 35 % =89,03 euro x 14 muaj, t'i paguaj shumën prej 1.246.42 apo në shumë të përgjithshme prej 3,959.62 euro si dhe shpenzimet e procedurës për precizimin e këkespadiisë në shumën prej 520 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (21.08.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar pjesa tjetër e ankesës së të paditurës Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahoves, Departamenti i përgjithshëm, C.nr.746/2021 i datës 13.07.2022 në pjesët tjera të vendosjes lidhur me pikën I dhe II të dispozitivit të tij VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë më Aktgjykimin e ankimuar C.nr.746/2021 të datës 13.07.2022 e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve **A..... B....., A..... K....., D..... M....., V..... G.....** dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që: Paditëses së parë **A..... B.....** nga Rahoveci, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prill 2017 e deri 31.12.2020, për 27 % të pagës mujore (421,00 €), 27 % =55,35 € x 44 muaj, t'i paguaj shumën prej 2,435.40 €.

2. Paditëses së dytë **A..... K.....** nga Rahoveci, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prill 2017 e deri 31.12.2020, për 35 % të pagës mujore (393,00 €), 35 % =83,10 € x 44 muaj, t'i paguaj shumën prej 3,656.40 €.

3. Paditësit të tretë **D..... M.....** nga Rahoveci, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prill 2017 e deri 31.12.2020, për 27 % të pagës mujore (421,00 €), 27 % =55,35 € x 44 muaj, t'i paguaj shumën prej 2,435.40 €.

4. Paditësit të katërt **V..... G.....** nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prill 2017 e deri 31.12.2020, për 35 % të pagës mujore (421,00 €), 35 % =89,03 € x 44 muaj, t'i paguaj shumën prej 3,917.32 €, apo në shumë të përgjithshme prej **12,444.52 €**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (21.08.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që në po të njëjtin afat, Paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1,216.00 me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij Aktgjykimit, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitivit të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që

ky aktgjykimi të ndryshohet ndërsa padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar apo që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësja ka ushtruar përgjegje në ankesë duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, par.1, pika d) dhe e), si dhe nenit 201, pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e palës së paditur është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit A..... B....., A..... K....., D.....M..... dhe V..... G....., përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar F..... H..... avokat nga Rahoveci, me datë 21.06.2021 ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, duke i propozuar gjykatës që të bëjë administrimin e provave dhe pas administrimit dhe vlerësimit të tyre, padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës B.....O..... ka deklaruar se në tërësi e kontestojnë kërkesëpadinë dhe precizimin e kërkesëpadiës të paditëses si të pabazuar dhe të pathemeltë ndaj të paditurës komuna e Rahovecit, me arsyetimin se është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për shkak se KKAK nuk ka paraparë pagesën në formën siç kërkohet dhe për shkak se përtej datës 18.04.2020 në mungesë të kontratës kolektive është e pabazë, si dhe të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv duke marrë për bazë se kontrata kolektive është nënshkruar nga organi i nivelit qendror nga MASHT dhe SBASHK, ndërsa e paditura nuk ka qenë nënshkruese e kësaj kontrate si nivel lokal, kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, me të cilin është paraparë që kontrata kolektive mund të lidhet në tri nivele. E paditura mendon që paditësja duke marrë për bazë theksimet si më lart është dashur që kërkesëpadinë ta drejtoj edhe ndaj Ministrisë së Arsimit si nënshkruese të kontratës në fjalë. E paditura në parim nuk ka kundërshtuar dispozitat e Kontratës Kolektive të cilat kanë qëllim përmirësimin e kushteve për mësimdhënësit por që në bazë të dispozitave që kanë implikime financiare nuk ka mundësi buxhetore dhe për të zbatuar këto dispozita pasi që palët kontraktuese në këtë kontratë nuk kanë zbatuar nenin 46 të së njëjtës. Mbrojtja e të paditurës mbetet në qëndrimin si në përgjigje në padi, ngase kontrata kolektive është nënshkruar në mes të MASHT dhe SBASHK dhe ashtu siç konstaton edhe Gjykata Kushtetuese në rastin numër KO139/18 se kjo kontratë reflekton vullnetin reciprok në mes të dy palëve nënshkruese. Sa i përket buxhetimit të mjeteve lidhur me kërkesëpadinë e paditëses e paditura në përgjigje në padi ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e alokimit të buxhetit për nivelin lokal siç është e paditura këtu, theksojmë se në bazë të qarkoreve buxhetore të Ministrisë së Financave për vitin 2019, 2020 dhe 2021 në asnjë nga këto qarkore të cilat konsiderohen dokumente bazë për krijimin e buxhetit vjetor, nuk është paraparë respektivisht nuk është alokuar asnjë mjet financiar për kompensimin e ushqimit apo të udhëtimit. Për vitin 2019 komunës së Rahovecit i janë alokuar mjetet në

shumën prej 22.967,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse, kjo në bazë të kalkulatorit sipas pikës 2.2 të kësaj qarkore. Në vitin 2020 komunës së Rahovecit i janë alokuar 46.643,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit, ndërsa për vitin 2021 në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit janë ndarë gjithsej 42.150,00 Euro dhe për herë të parë janë ndarë 27.169,00 Euro në emër të pagave jubilarë sipas kontratës kolektive andaj përtej kësaj që është paraparë në Ligjin për Buxhetin e RKS-së dhe ndarjes buxhetore, e paditura nuk ka kompetencë ligjore për të kryer pagesat tjera në emër të kompensimeve sipas kontratës kolektive të arsimit para universitar. Rrjedhimisht për të gjitha vitet sipas kërkesës për kompensimin e licencimit janë përtej mundësive ligjore për të kryer pagesa sipas kërkesëpadisë së paditësve. Në aspekt procedural gjykata nuk ka vepruar në përputhje me nenin 67 dhe 68 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i propozojmë gjykatës që kësaj lënde të ia bashkojë edhe lëndë të tjera me paditës me bazë të njëjtë të padisë në emër të parimit të ekonomizimit të procedurës. E paditura mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, në veçanti ritheksoj çështjen e periudhës kohore përtej datës 22.01.2021, për faktin se kontrata kolektive e viti 2017 është shfuqizuar, me këtë datë me nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së re të Arsimit, pikërisht me datën 22.01.2021. Kontrata e Re ka përcaktuar rregulla tjera për pagesat e kompensimeve, e sipas të njëjtës nuk mund të kërkohej kompensim para vitit 2023, sepse për këtë periudhë i është dhënë mundësia palëve kontraktuese që ti kryejnë obligimet deri në fund të vitit 2023, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësës përtej datës 22.01.2021, është e pabazuar. Gjithashtu kemi vërejtje në mënyrën e parashtrimit të padisë në mungesë të provave dhe për këtë konsiderojmë se parashtrësja për precizimin e kërkesëpadisë me provat e bashkangjitura kanë mundur të dorëzohen të bashkangjitura me padinë, ngase sipas datës të nxjerrjes së provave, vërehet se këto prova paditësja i ka pasur në dispozicion edhe në momentin e parashtrimit të padisë. Gjithashtu deklaroi se KKAK në nenin 7 nuk ka përcaktuar se duhet të kompensohet mësimdhënësi me përqindjen sipas kërkesëpadisë po ashtu nëse ky kompensim duhet të bëhet nga punëdhënësi drejtpërdrejtë, andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv në kuptim të dispozitës së nenit 7 të KKAK, për të qenë palë në këtë procedurë. Paditësja është licencuar më 29.12.2015 me licencë valide deri më 29.12.2020, ndërsa e njëjta është paguar në bazë të listës së pagave në emër të kualifikimit. Lidhur me objektin e shqyrtimit lëndor i propozojmë gjykatës që ti bashkoj subjektet paditëse në grupe sipas shkollave ngase me këtë hyjnë në zbatim parimi i ekonomizimit të procedurës si në sqarim në përgjigje në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.746/2021 të datës 13.07.2022 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se përmes të kontratave të punës në emër të paditësve është kontaktuar fakti se paditësit kanë që të sistemuar tek e paditura në cilësinë e mësimdhënësve. Përmes diplomës nr. 1236 të datës 17.07.2013 për paditësen A..... B..... vërtetohet e njëjta është diplomuar në drejtimin matematikë - informatikë. Nga licenca me nr. 100022463 e datës 29.10.2014, vërtetohet se paditësja A..... B..... është pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt, ndërsa nga lista e pagave vërtetohet

se paditësja A..... B..... është kompensuar në shumë prej 58,32 euro. Nga diploma e fakultetit nr. 661 të datës 18.04.2016, për paditësen A..... K....., vërtetohet se është diplomuar në Departamentin e Pedagogjisë. Nga licenca nr. 1027696 i datës 05.11.2019, vërtetohet se paditësja A..... K..... është pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt, nga lista e pagave vërtetohet se paditësja A..... K..... është kompensuar në shumë prej 54,45 euro. Nga diploma nr. 1225 të datës 04.04.2016 për paditësin, vërtetohet se është diplomuar në drejtimin kimi - fizikë. Nga licenca numër 100023995, i datës 16.11.2016, vërtetohet se paditësi D.....M..... është pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt, ndërsa nga lista e pagave vërtetohet se paditësi D..... M..... është kompensuar në shumë prej 58,32 euro. Nga diploma e fakultetit nr. 98 të datës 29.10.2015, vërtetohet se ka marrë titullin Master i Edukimit. Paditësi është pajisur me licencë 100009869, i datës 26.12.2012, ndërsa me shikimin në listën e pagave vërtetohet se paditësi V..... G..... është kompensuar në shumë prej 58,32 euro. Andaj, gjykata e aprovoi në tërësi të themeltë kërkesëpadinë e paditësve duke e mbështet vendimin e saj në nenin 7 paragrafi 1, pika 3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata vendosi sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e të paditurës brenda kufijve të saj, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.2 pika b), g), j), k) dhe m), si dhe për zbatimin e së drejtës materiale vjen në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera që pretendohet me ankesë, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për një pjesë të kërkesëpadisë së paditësve për sa i përket kompensimit mbi bazën e kualifikimit, për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në këtë pjesë dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pazazuara pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, e po ashtu nuk ka kundërthënë në mes arsyetimit të aktgjykimit dhe përmbajtjes së provave të administruara, për pjesën e vërtetuar.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pazazuara pretendimet ankimore të palës së paditur se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë dhe se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk e obligon të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare, pasi që vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura, andaj edhe ka

legjitimitet real pasiv për të qenë palë e paditur në procedurën konkrete kontestimore dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Po ashtu, Gjykata e Apelit i refuzon si të pathemelta pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se paditësja nuk i kanë shtjerr mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ e kjo për faktin se e drejta e punës është kategori kushtetuese e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (*kërkesat materiale*) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, (sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës ku aplikohet neni 78, neni 79 dhe neni 82 i Ligjit të Punës) e krejt kjo duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, ku me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësit në asnjë rrethanë nuk mund t’iu mohohen të drejtat për të kërkuar mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, në raport me kulifikimin-licencimin, e kjo për arsyeje se me nenin me nenin 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë parashihet se *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10% e pagës bazë, 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë, 1.4 Mësimdhënës me diplomë vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoratë 35% e pagës bazë*, ndërsa me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008 parashihet se *nga 1 Shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësve etj do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me një ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktorate) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %*, prandaj, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësës si të bazuar, për pjesën e vërtetuar. Po ashtu, edhe sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 214/2023 të datës 05.10.2023 çështja e kompensimit mbi bazën e kualifikimit është trajtuar ashtu që sipas këtij mendimi *“për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008”* si dhe *“punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021* ,

kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.

Mirëpo, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ia ka aprovuar kërkesëpadinë paditëses, përkitazi për shpërblimin në emër të kualifikimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 18.06.2018 ngase kërkesëpadia e paditëve sa i përket kësaj periudhe kohore është e parashkruar. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Me dispozitat e nenit 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”.* Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”.* Me paragrafin 4 përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.*

Po ashtu me nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë parashihet se *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10% e pagës bazë, 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë, 1.4 Mësimdhënës me diplomë vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoratë 35% e pagës bazë.*

Nga interpretimi i kësaj dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit, nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, për arsye se në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 18.06.2018 është e parashkruar duke marrë parasysh se paditësja e ka ushtruar padinë në gjykatë me datë 21.07.2021, pasi që nga koha kur paditësit iu është krijuar baza ligjore për realizimin e të drejtës për kompensimin në bazë të kualifikimit (data 18.04.2017 deri me datë 18.06.2018) kanë kaluar më shumë se tre vite.

Gjykata e Apelit duke e vlerësuar pretendimin e të paditurës për parashkrim, e cila me rastin e përgjegjës në padi të dhënë me datë 23.06.2022 është thirr në institutin e parashkrimit e po ashtu edhe në ankesë ka theksuar se kërkesëpadia është pjesërisht e parashkruar, gjen se në

këtë çështje juridike kontestuese kërkesëpadia e paditëses për periudhën kohore 18.04.2017-18.06.2018 është e parashkruar për çka vendosi që ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë.

Në këtë rast Gjykata e Apelit i është referuar dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212 me të cilën përcaktohet afati i parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës, me të cilën dispozitë në mënyrë specifike përcaktohet se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Gjithashtu, rezulton i bazuar, pretendimi e të paditurës sa i përket pjesës së kërkesëpadisë së paditësit për shpenzimet procedurale, në emër të precizimit të kërkesëpadisë në shumën prej 520 euro, ngase sa i përket parashtrësës për precizimin e padisë e njëjta nuk mund ti nënshtrohet kompensimit në lartësinë sikurse bëhet kompensimi për padi dhe se kjo parashtrësë nuk rezulton që të kompensohet sipas tarifës së OAK-së, dhe nisur nga kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret shpenzimet e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë në shumën si me lartë duhet të ndryshohen dhe palës paditëse ti refuzohet kërkesa për kompensimin e shpenzimeve sa i përket parashtrësës për precizim të padisë, prandaj në kuptim të nenin 449 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me nenin 450 dhe 453 paragrafi 1 të LPK-së, gjykata vlerësoi se duhet të ndryshohet pjesërisht pika e II e dispozitivit të aktgjykimit ankimor duke e refuzuar këtë pjesë të kërkesëpadisë së palës paditëse.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), në lidhje me nenin 200 dhe 201 pika (d) të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7097/2022, me datë 17.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Ardian Ajvazi